



AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Dobësi e Injektivit të Komandave në TP-Link Telnet CLI

Data: 17/03/2026
Version: 1.0

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	1
Informacione Teknike	1
Rekomandime	1
Referenca	1

Përmbledhje Ekzekutive

Një dobësi me rrezikshmëri të lartë e tipit **injektim komandash (CVE-2026-3841)** prek ruterët **TP-Link TL-MR6400** që përdorin versione të caktuara firmware.

Dobësia ekziston në ndërfaqen **Telnet CLI (Command Line Interface)** për shkak të filtrimit të pamjaftueshëm të input-it të dhënë nga përdoruesi gjatë operacioneve të caktuara.

Një sulmues i autentikuar me privilegje të larta mund ta shfrytëzojë këtë dobësi për të:

- ekzekutuar komanda arbitrare në sistem
- marrë kontroll mbi pajisjen
- komprometuar funksionimin e ruterit

Informacione Teknike

Detaje të Dobësisë:

- **CVE ID:** CVE-2026-3841
- **Produkti i prekur:** TP-Link TL-MR6400
- **Lloji i dobësisë:** Injektim komandash
- **Vektori i sulmit:** Rrjet i afërt (ndërfaqja Telnet)
- **CVSS v4.0:** 8.5 (E lartë)

Produktet dhe Versionet e Prekura

- **TP-Link TL-MR6400 v5.3**
- Versionet më të hershme se **1.9.0 Build 260108**

Rekomandime

Përditësoni firmware-in e ruterëve të prekur në versionin e korrigjuar ose në versionin më të fundit të publikuar nga TP-Link.

Referenca

<https://www.tp-link.com/us/support/faq/5016/>